



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të GOE "Valdrini Sh.P.K. & NN Shkëmbi & LD Construction Sh.P.K." të datës 05.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e GOE "Valdrini Sh.P.K. & NN Shkëmbi & LD Construction Sh.P.K." e datës 05.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Valdrini Sh.P.K. & NN Shkëmbi & LD Construction Sh.P.K." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

GOE "Valdrini Sh.P.K. & NN Shkëmbi & LD Construction Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 05.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi nr. 1:

-Pergjigjia jonë : Ky pretendim i AK nuk qendron fare pasi qe ne kemi dorzuar : CD -Formularin e deklarimeve vjetore dhe pageses per tatimin ne te ardhurat e korporatave (deklaratat dorzuara ne ATK sipas kerkeses se dt.) per Liderin e grupit Valdrini sh.p.k per tre vitet e fundit : 2020,2021 dhe 2022 te cilat kapin vleren : 698,232.95 € Dhe kemi dorzuar PD-Formularin e deklarimeve vjetore dhe pagesave per tatimin ne te ardhura personale (Deklaratat e dorzuara ne ATK sipas kerkeses se Dt.) per partnerin e grupit : Ibrahim Kurumeli B.I (NN Shkëmbi) per tre vitet e fundit : 2020,2021 dhe 2022 te cilat kapin vleren :1,338,372.85 € , **totali i qarkullimit vjetor te dy antareve te grupit eshte : 2,036,605.8 € , kjo shumë është me e madhe sesa kërkesa e AK ne dt. Dhe e ploteson bindshëm këtë kërkesë.**

Pretendimi nr. 2:

-PERGJIGJIA JONË : Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri Hivzi Kabashi ka diplomuar ne vitin 2006 ashtu siqë shenon ne diplomën e tij **STUDIMET I MBAROI MË 27 TETOR 2006. Dhe e ploteson bindshëm kërkesën e AK 7 vite përvijë pune pas diplomimit , nderesa data Prishtine ,9 mars 2022 eshte date e rinxjerrjes se diplomes(duplikat) , eshte jo profesionale per kete vlersim te AK lidhur me leximin e datave te mbarimit te studimeve pasi qe eshte shume e kjarre qe studimet i ka mbaru ne vitin 2006 (kjo eshte data e diplomimit dhe kjo date 27 tetor 2006 mirret si date e mbarimit te studimeve) , si deshmi Ne mund te ju sjellim edhe diplomën e vjeter ose ndonje konfirmim nga Universiteti i Prishtines.**

Pretendimi nr. 3:

-PERGJIGJIA JONË: Ky pretendim i AK nuk qendron , pasi qe Inxhinieri z.Faruk Kryeziu ne Cv-ne e ofruar shihet qarte se ka punuar qe nga viti 2006 e deri me tani dhe ka nje përvijë pune shume te madhe mbi 17 vite. Po ashtu me sqarimet e kerkuara nga AK kemi ofruar deshmite e kerkuara Pervoja e punes mbi 5 vite permes vertetimave te Atk-se nga viti 2018 deri 2023 te cilet deshmojne se z.Faruk Kryeziu ka përvijën e kerkuar dhe poashtu Faruk Kryeziu ka biznesin e tij personal si person fizik per projektim,ndertim dhe mbikqyrje te projekteve ndertimore te cilin e kemi deshmuar me vertetima te atks per vitet : 2018,2019,2020 per te cilat vite i ka vetpague tatimet e tij nga kompania e tij si person fizik dhe poashtu kemi ofruar vertetimat tatimor per vitet 2021,2022 dhe 2023 nga kompania NN Andi Grup ne te cilen punon Faruk Kryeziu dhe i paguhen tatimet ne Atk dhe si i tille Faruk Kryeziu eshte ne Listat e Atk-se qe nga viti 2006 e deri tani.

Pretendimi nr. 4:

Ne kemi marrur qasje edhe ne dokumentet e GOE : FLAMURI V SH.P.K & BENITA COMPANY SH.P.K ,Dhe kemi gjetur shume gabime :

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshme:

- **Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit**

ARSYETIM

Tenderi juaj eshte refuzuar për këto arsye :

- **Ju si GOE-ik nuk keni përmbushur kërkesën nr. 1 lidhur me Kapaciteti ekonomik dhe financiar sipas dosjes së tenderit: KERKESA: 1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 2.000.000,00 Euro. DESHMIA 1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Komisioni i vlerësimit për këtë pike te kërkesës ka gjetur se GOE- sipas dokumenteve te dorëzuara nuk ka arritur te përmbushe kërkesën sipas dëshmimeve GOE ka dorëzuar dëshmi vetëm për 1.8 milion euro.**
- **Ju si GOE-ik nuk keni përmbushur kërkesën nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional (për staf) sipas dosjes së tenderit: - Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndërtimitarisë master në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvijë pune profesionale pas diplomimit. KERKESA: - Diplomat universitare ne baze te kërkesave te kerkuar –**

Kopjet e Noterizuar për secilën diplomë të kërkuar CV-në e nënshkruar nga kandidati; Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vërtetimeve të ATK-se . Lidhur me pikën e parë të kërkesës “Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndërtimit në drejtimin konstruktiv, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit”, GOE ka përcaktuar z. Hivzi Kabashi. Bazuar në diplomën e dorëzuar për menaxherin e projektit – inxhinierin e ndërtimit, është gjetur se i njëjti ka diplomuar dhe ka marrë titullin “Inxhinier i diplomuar i ndërtimit” me datë 09.03.2022. Ky fakt është provuar përmes kopjes së noterizuar të diplomës. Mirëpo sipas dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Duke marrë parasysh faktin që njoftimi për kontratë është publikuar në tetor të vitit 2023, rezulton se menaxheri i projektit i cili duhet të jetë edhe inxhinier i ndërtimit – drejtimi konstruktiv nuk e përmbushë kërkesën për përvojë të punës prej shtatë (7) viteve pas datës së diplomimit. Duhet cekur faktin që në diplomën e menaxherit potencohet që i njëjti ka regjistruar studimet në vitin 2001 ndërsa ka përfunduar provimet në vitin 2006, mirëpo nuk ka arritur të diplomoj deri në vitin 2022. Periudha kur janë regjistruar dhe kur janë përfunduar provimet (2001 deri 2006) korespondojnë edhe me datat që janë evidentuar në CV të menaxherit. Mirëpo duhet pasur parasysh që përmes dosjes së tenderit janë kërkuar shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Pra nuk është fare relevante nëse ndërmjet datës kur janë përfunduar provimet dhe datës së diplomimit ekziston një hapësirë e konsiderueshme kohore (si në rastin konkret). Për këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh dosjen e tenderit është relevante vetëm data e diplomimit (09.03.2022). Lidhur me personin në fjalë janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referenca, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

- **Ju si GOE-ik** nuk keni përmbushur kërkesën nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional (për staf) sipas dosjes së tenderit: - Një (1) Inxhinier i Ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite përvojë pune pas diplomimit. KERKESA: - Diplomat universitare në bazë të kërkesave të kerkura – Kopjet e Noterizuar për secilën diplomë të kërkuar CV-në e nënshkruar nga kandidati; Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vërtetimeve të ATK-se . • Lidhur me pikën e dytë të kërkesës “Një (1) Inxhinier i Ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite përvojë pune pas diplomimit”, GOE ka përcaktuar z. Faruk Kryeziu. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Sa i përket dëshmisë mbi pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit, janë dorëzuar edhe disa vërtetime nga ATK për vitet 2018-2023. Në fakt këto vërtetime nuk janë dorëzuar përmes ofertës por janë dorëzuar vetëm pas sqarime shtesë të datës 20.11.2023 të kërkuara nga autoriteti kontraktues. Mirëpo pas analizimit të këtyre vërtetimeve është gjetur si vijon:

- Faruk Kryeziu nuk figuron fare në listën e punëtorëve në vërtetimin e ATK për vitin 2018 dhe për vitin 2019.
- I njëjti është evidentuar si punonjës vetëm në vërtetimin e ATK të vitit 2020 ku përcaktohet se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) gjatë vitit 2020 i ka vetëm tetë (8) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i pestë (5) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2021 personi në fjalë sipas vërtetimit të ATK figuron se gjatë vitit 2021 i ka vetëm njëmbëdhjetë (11) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i dytë (2) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2022 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka dymbëdhjetë (12) muaj të përvojës së punës respektivisht vitin e plotë.
- Ndërsa në vitin 2023 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka nëntë (9) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i parë (1) deri te muaji i nëntë (9).
- Nga sa u tha më sipër përmes vërtetimeve të ATK (listës së pagave) të dorëzuara nga GOE është konstatuar se z. Faruk Kryeziu i ka vetëm dyzet (40) muaj përvojë të punës. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit janë kërkuar së paku pesë (5) vite apo gjashtëdhjetë (60) muaj të përvojës së punës pas diplomimit. Bazuar në dokumentet që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përmes ofertës por edhe në dokumentet shtesë të dorëzuara si sqarime me datë 20.11.2023, tenderuesi i rekomanduar për këtë pikë të kërkesës në fjalë (inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv) nuk ka arritur të dëshmojë se z. Faruk Kryeziu i ka së paku pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit. Kjo pasi që nuk janë dorëzuar kontratat me punëdhënësit me të cilët është zhvilluar kjo marrëdhënie e punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në anën tjetër as përmes vërtetimeve nga ATK – listave të pagave nuk është vërtetuar se personi në fjalë e ka pëmbushur kërkesën e përvojës së punës prej pesë (5) viteve. Lidhur me personin në fjalë (z. Faruk Kryeziu) janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referenca, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.
- Ju si GOE- Për Inxhinierin Faruk Kryeziu ka dorëzuar CV-ne, mirëpo CV-ja e dorëzuar nuk pëmbush kërkesat minimale dhe sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik - CV-ja e dorëzuar nuk pëmbush kërkesat /REFUZO tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshëm NENI 69 i LPP-së.

Andaj për arsyeje të lartë cekura jeni eliminuar për këtë aktivitet të prokurimit

Lidhur me pretendimin nr. 2 dhe 3 - këto pretendime i referohen kërkesës së formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

<ul style="list-style-type: none"> - Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndërtimtarisë master në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit - Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite pervoje pune pas diplomimit - Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë - Drejtimi i Hidroteknikës 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Një (1) Inxhinier i Elektroteknikës - Energjetikës apo bachelor 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë -Gjeodezisë 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Dy (2) Teknik - Drejtimi i Ndërtimtarisë (bachelor) 3 vite pervoje pune pas diplomimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Diplomat universitare ne baze te kerkesave te kerkura - Kopjet e Noterizuar per secilen diplome te kerkuar; •CV-në e nënshkruar nga kandidati; •Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vërtetimeve të ATK.
--	---

Lidhur me pikën e parë të kërkesës "Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndertimtarisë në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit", parashtruesi ka përcaktuar z. Hivzi Kabashi. Bazuar në diplomën e dorëzuar për menaxherin e projektit - inxhinierin e ndertimtarisë, është gjetur se i njëjti ka diplomuar dhe ka marrë titullin "Inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë" me datë 09.03.2022. Ky fakt është provuar përmes kopjes së noterizuar të diplomës.

	REPUBLIKA E KOSOVËS UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"	REPUBLIC OF KOSOVO UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"	
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË		FACULTY OF CIVIL ENGINEERING	
<h1>Diplomë Diploma</h1>			
HIVZI SAHIT KABASHI			
U lind më 22.08.1981 në Istog.		Born on 22.08.1981 in Istog.	
U regjistrua në vitin akademik 2000/2001.		Was enrolled in the academic year 2000/2001.	
Studimet i mbaroi më 27 tetor 2006 në:		Completed his/her studies on 27 October 2006 in:	
DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV		DEPARTMENT OF CONSTRUCTIONS	
dhe mori titullin:		and was awarded the title:	
INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË		DIPLOMA ENGINEER OF CIVIL ENGINEERING	
Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6		Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 6	
Nota mesatare gjatë studimeve 6,79		Average grade of studies 6,79	
Nota e provimit të diplomës 9,00		Diploma examination grade 9,00	
Prishtinë, 9 mars 2022		Prishtina, 9 March 2022	
Nr.1264			
 Dekani / Dean Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci		 Rektori / Rector Prof. Dr. Naser Sahiti	

LRP nr. 262/2023

VËRTETIM I KOPJES SË ORIGINALIT

Astrit S. Bibaj, noter në Prishtinë, Rruga "Garibaldi" nr.15/5, vërteton se: _____
Kopja e dokumentit që i prinë tekstit, e verifikuar nga noteri, në të gjitha pikëpamjet është konform kopje identike me origjinalin e sjellë nga pala: _____
z. **HIVZI KABASHI**, i lindur me datë: **22/08/1981**, (njëzet e dy gusht një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) në: **Istog**, bartës i dokumentit të identifikimit të lëshuar nga MPB-RKS, me nr. personal: **1005785347**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. _____

Dokumenti: **Diplomë**, me nr. **1264**, e datës: **9 mars 2022**, lëshuar nga: **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"** – Fakulteti i Ndërtimtarisë, e sjell nga pala është prezantuar si original dhe noteri, nuk merr përgjegjësi për përmbajtjen e këtij dokumenti dhe informatat që ka dokumenti dhe pala garanton për vërtetësinë e tyre.

Veprimi i noterizimit u bë në Prishtinë, në zyrën e noterit, me datë: shtatëmbëdhjetë janar dy mijë njëzet e tre (17.01.2023), h 09:16

Dokumenti i sjellë nga pala është fotokopjuar në zyrën e noterit, ka **1** faqe, është zvogëluar nga formati A3 në formatin A4, është vërtetuar në 1 kopje-ekzemplar, dhe është paguar në shumën prej **1 € + 10 cent** për faqe + TVSH në bazë të nenit 29, dhe neni 42 pika nr. 1 konform U.A. për Tarifat Noteriale nr. 05/2022.



Faqe 5 nga 10

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Sipas dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Duke marrë parasysh faktin që njoftimi për kontratë është publikuar në tetor të vitit 2023, rezulton se menaxheri i projektit i cili duhet të jetë edhe inxhinier i ndërtimit - drejtimi konstruktiv nuk e përmbushë kërkesën për përvojë të punës prej shtatë (7) viteve pas datës së diplomimit. Duhet cekur faktin që në diplomën e menaxherit potencohet që i njëjti ka regjistruar studimet në vitin 2001 ndërsa ka përfunduar provimet në vitin 2006, mirëpo nuk ka arritur të diplomoj deri në vitin 2022. Periudha kur janë regjistruar dhe kur janë përfunduar provimet (2001 deri 2006) korespondojnë edhe me datat që janë evidentuar në CV të menaxherit. Mirëpo duhet pasur parasysh që përmes dosjes së tenderit janë kërkuar shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Pra nuk është fare relevante nëse ndërmjet datës kur janë përfunduar provimet dhe datës së diplomimit ekziston një hapësirë e konsiderueshme kohore (si në rastin konkret). Për këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh dosjen e tenderit është relevante vetëm data e diplomimit (09.03.2022). Sa i përket pikës së pretendimit të parashtruesit ku thuhet se kjo diplomë “është duplikat” duhet cekur se në dokumentin në fjalë (në diplomë) nuk përmendet fare fjala “duplikat” ngjashëm sikurse nuk përmendet kjo fjalë as në vërtetimin e noterit që është dorëzuar lidhur me këtë diplomë. Pra nuk qëndron pretendimi se bëhet fjalë për duplikat të diplomës sepse po të ishte kështu atëherë në diplomë do të duhej të theksohej ky fakt. Përderisa nuk theksohet as në diplomë as në vërtetimin noterial, pretendimi është i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pikën e dytë të kërkesës (pretendimi nr. 3) “Një (1) Inxhinier i Ndërtimitarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite pervoje pune pas diplomimit”, GOE ka përcaktuar z. Faruk Kryeziu. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Sa i përket dëshmisë mbi pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit, janë dorëzuar edhe disa vërtetime nga ATK për vitet 2018-2023. Në fakt këto vërtetime nuk janë dorëzuar përmes

ofertës por janë dorëzuar vetëm pas sqarime shtesë të datës 20.11.2023 të kërkuara nga autoriteti kontraktues. Mirëpo pas analizimit të këtyre vërtetimeve është gjetur si vijon:

- Faruk Kryeziu nuk figuron fare në listën e punëtorëve në vërtetimin e ATK për vitin 2018 dhe për vitin 2019.
- I njëjti është evidentuar si punonjës vetëm në vërtetimin e ATK të vitit 2020 ku përcaktohet se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) gjatë vitit 2020 i ka vetëm tetë (8) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i pestë (5) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2021 personi në fjalë sipas vërtetimit të ATK figuron se gjatë vitit 2021 i ka vetëm njëmbëdhjetë (11) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i dytë (2) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2022 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka dymbëdhjetë (12) muaj të përvojës së punës respektivisht vitin e plotë.
- Ndërsa në vitin 2023 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka nëntë (9) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i parë (1) deri te muaji i nëntë (9).

Nga sa u tha më sipër përmes vërtetimeve të ATK (listës së pagave) të dorëzuara nga GOE është konstatuar se z. Faruk Kryeziu i ka vetëm dyzet (40) muaj përvojë të punës. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit janë kërkuar së paku pesë (5) vite apo gjashtëdhjetë (60) muaj të përvojës së punës pas diplomimit. Bazuar në dokumentet që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përmes ofertës por edhe në dokumentet shtesë të dorëzuara si sqarime me datë 20.11.2023, tenderuesi i rekomanduar për këtë pikë të kërkesës në fjalë (inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv) nuk ka arritur të dëshmoj se z. Faruk Kryeziu i ka së paku pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit. Kjo pasi që nuk janë dorëzuar kontratat me punëdhënësit me të cilët është zhvilluar kjo marrëdhënie e punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në anën tjetër as përmes vërtetimeve nga ATK – listave të pagave nuk është vërtetuar se personi në fjalë e ka pëmbushur kërkesën e përvojës së punës prej pesë (5) viteve. Lidhur me personin në fjalë (z. Faruk Kryeziu) janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referenca, deklaratë, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor ku thuhet se personi në fjalë ka një biznes të tij privat për të cilin ka paguar tatime, duhet cekur se në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar që inxhinieri të ketë përvojë të punës profesionale si inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv apo ndërtimi i rrugëve dhe jo përvojë si pronar i biznesit apo përvojë tjetër. Në rastin konkret komisioni ka nxjerrë konstatimin nga vlerësimi i atyre dokumenteve me të cilat ka ofertuar vet parashtruesi. Komisioni as nuk mundet dhe as duhet që të vlerësoj mbi bazën e dokumenteve që nuk janë pjesë e ofertës së parashtruesit. Prandaj mbi bazën e atyre vërtetimeve tatimore që parashtruesi ka dorëzuar është gjetur se personi në fjalë gjatë viteve 2018-2023 i ka vetëm 40 muaj përvojë të punës profesionale dhe nuk i ka 60 muaj përkatësisht 5 vite sikurse është kërkuar me dosje të tenderit.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor nr. 3 është i pabazuar në tërësi.

Vlen të shtohet po ashtu se parashtruesi nuk e konteston fare një pikë tjetër për shkak të cilës është eliminuar si i papërgjegjshëm sipas vendimit të AK. Konkretisht në vendimin e AK si arsye shtesë për eliminimin është përcaktuar po ashtu se:

- Ju si GOE- Për Inxhinierin Faruk Kryeziu ka dorëzuar CV-ne, mirëpo CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale dhe sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik - CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat /REFUZO tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshëm NENI 69 i LPP-së.

Nga administrimi me ofertën e parashtruesit është gjetur se CV e inxhinierit Faruk Kryeziu nuk i përmbush kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit. Në fakt po të analizohet CV si e vetme, është shumë e vështirë që të kuptohet se CV e kujt është sepse aty nuk figuron as emri i personit për të cilin është dorëzuar CV. Në fakt CV si e tillë më shumë i përngjan një liste të projekteve kur pretendohet se ka marrë pjesë personi në fjalë sesa një CV me të dhënat bazike të një biografike standarde. Prandaj në kuptim të UPP lidhur me nenin 69 të LPP ku përcaktohet se kur "CV nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacione mëtejshëm". Duke marrë parasysh se parashtruesi këtë fakt nuk e konteston fare me kërkesën e tij për rishqyrtim, atëherë ky fakt mbetet i pakontestueshëm përmes të cilit rikonfirmohet papërgjegjshmëria e parashtruesit.

Përtej pretendimeve ankimore por edhe përtej të gjeturave në raportin vlerësues, pas administrimit me ofertën e parashtruesit lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim, është gjetur që sa i përket pikës së pestë të kërkesës "Një (1) Inxhinier i Ndërtimitarisë - Gjeodezisë 5 vite përvioje pune pas diplomimit", parashtruesi ka përcaktuar z. Luan Abazi. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvioje të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvioja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar as kontratat të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Luan Abazi) ka së paku pesë (5) vite përvioje të punës pas diplomimit dhe as vërtetimet nga ATK - Listat e pagave. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përviojes së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Përderisa nuk janë dorëzuar as kontratat e punës dhe as vërtetimet përkatëse nga ATK, nuk është arritur që të dëshmohet përvioja e punës pas diplomimit për personin në fjalë. Vlen të thuhet po ashtu se as përmes ofertës mirëpo as përmes sqarimeve shtesë nuk është dorëzuar diploma bachelor (studimet themelore) për inxhinierin e gjeodezisë z. Luan Abazi. Në vend të kësaj është dorëzuar diploma e studimeve master megjithatë është dashur patjetër që të dorëzohet edhe diploma e studimeve bachelor pasi që e njëjta është kërkuar edhe përmes dosjes së tenderit ku askund nuk përmendet diploma master. Rrjedhimisht parashtruesi nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin nr. 1 – ky pretendim i referohet kërkesës së formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 2.000.000,00 Euro.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.
--	-----------	--	--

Parashtruesi me qëllim të përmbushjes së kësaj kërkesë ka dorëzuar deklaratat në atk për OE Valdrini dhe Ibrahim Kurrumeli BI. për periudhat 1 janar 2020 deri me datë 31 dhjetor 2022. Qarkullimi vjetor bruto i këtyre dy OE gjatë kësaj periudhe është mbi 2 milion euro. Megjithatë duke marrë parasysh të thënat tjera në këtë vendim, rezulton se miratimi i këtij pretendimi nuk mund të ndryshoj epilogun vendimtar të njoftimit mbi vendimin kundër të cilit është parashtruar kjo kërkesë për rishqyrtim.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore (pretendimi nr. 4) të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektini duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Në fakt oferta e tenderuesit të rekomanduar është e vetmja ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.05.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.